



Kolegji ESLG

Në bazë të nenit 22 paragrafi 3 pika 12 e Statutit të Kolegjit ESLG dhe në bazë të nenit 2 të Rregullores mbi procedurën e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të Kolegjit ESLG, Senati i Kolegjit ESLG në mbledhjen e mbajtur me korrespondencë më 06.11.2019 nxjerri si në vijim:

VENDIM

Për emërimin e grupeve punuese për hartimin e raportit të vetëvlerësimit dhe procedurën e vetëvlerësimit për riakreditimin e programeve studimore të Kolegjit ESLG si në vijim:

- Doc. Dr. Visar Hoxha, Dr. Veli Lecaj, Dr. Hazer Dana, Dr. Mersiha Kaçamakovic, M.Sc. Jehona Hoxha, Taulant Blakaj (student) dhe Ardita Kurteshi (studente) për përgatitjen e raportit të vetëvlerësimit dhe procedurën e vetëvlerësimit për programin studimor Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (BA);
- Doc. Dr. Visar Hoxha, Dr. Islam Hasani, Albina Vuthi (studente) dhe Eljesa Arifi (studente) për përgatitjen e raportit të vetëvlerësimit dhe procedurën e vetëvlerësimit për programin e studimeve Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA);

ARSYETIM

Më 06.11.2019 Senati i Kolegjit ESLG me propozim të Rektorit të Kolegjit ESLG në mbledhjen e mbajtur me korrespondencë ka marrë vendim për emërimin e grupeve punuese për hartimin e raportit të vetëvlerësimit dhe kryerjen e procedurës së vetëvlerësimit të programeve studimore Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (BA) dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA).

Neni 22 paragrafi 3 dhe pika 12 e Statutit të Kolegjit ESLG i cili parashikon kompetencat e senatit thotë se Senati emëron organet e punës për kryerjen e punëve në fushat e caktuara.

Gjithashtu neni 2 i Rregullores mbi Procedurën e Vetëvlerësimit dhe vlerësimit të Kolegjit ESLG parashikon se pas propozimit të rektorit, Senati në mbledhjen e vet cakton ekipin e vetëvlerësimit për programe studimore e cila përbëhet nga më së paku tre anëtarë.

Anëtarët e caktuar nga Senati i Kolegjit ESLG janë bartës të programeve studimore si dhe përfaqësues të studentëve dhe zyrës së cilësisë së Kolegjit ESLG.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ brenda 30 ditëve nga nxjerrja e këtij vendimi.

Dorëzohet:

- Arkivit

Kolegji ESLG
Nazim Gafurri 33
10000 Prishtina Kosovo
Tel: 038 602 405
M: 045 456 666
E-mail: info@eukos.org

Doc. Dr. Visar Hoxha
Rektor, Kryesues i Senatit

